



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Adresa: Blvd. "Republika", Berat, Shqipëri, Website: www.bashkiaberat.gov.al Email : info@bashkiaberat.gov.al

PROCESVERBAL I TAKIMIT DATE 02 NENTOR 2022

Vendi : Qendra Multifunkionale Rinore Berat

Ora: 11:00

Tema e Konsultimit : Degjese tematike met e rinj e te reja **“Buxheti vendor per Rinine 2023”** dhe prioritetet e investimit ne Bashkine Berat.

BAZA LIGJORE : Ne zbatim të Ligjit nr. 146/2012 "Per njoftimin dhe konsultimin publik" pika 1 dhe 2 neni 5, Ligjit Nr.75/2019 “Per Rininë”, nenit 1-7, të si dhe ligjit nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", neni 18 dhe VKB-ne Nr.70 date 14.12.2021 “Per miratimin e kalendarit te pergatitjes se PBA-se 2023-2025 dhe Buxhetin vjetor 2023”.

Ditën e Mërkurë , më datë 02 Nëntor 2022, në orën 11:00 u zhvillua takimi i konsultimit publik në Bashkinë e Beratit me të rinjtë e qytetit, në kuadër të prioriteteve buxhetore të Bashkisë në fushën e rinisë. **Takimi u zhvillua në Qendrën Multifunkionale Rinore Berat.** Në takim ishin të pranishëm Kryetari i Bashkisë Z. Ervin Demo, Drejtuesja e Qendrës Rinore znj. Fitore Sulejmani, Drejtori Ekzekutiv i INFOCIP z. Gerti Shella, anëtarë të Këshillit Vendor Rinor si dhe rreth 60 gjimnaziste / student.

Takimi u hap nga drejtuesja e Qendrës Multifunkionale Berat znj. Fitore Sulejmani, e cila pas falenderimeve, përshendetjeve dhe prezantimive ndaj pjesëmarrësve, vuri theksin se thelbi i diskutimit për këtë konsultim i dedikohej buxhetit afatmesem per rinine. Znj. Sulejmani bëri me

dije se tashmë ka një ligj për buxhetimin rinor dhe të rinjve i krijohen hapësira për të shprehur mendime, ide, kërkesa, kritika etj. Drejtuesja u shpreh se dëshira e saj por jo vetëm është që Berati dhe Qendra Rinore vitin e ardhshëm të jene “The Youth Capital of Euro Pean”. Znj.Fitore pas fjalës së saj shumë shpresëdhënësë për rinine i kaloi fjalën Kryetarit të Bashkisë Z. Ervin Demo.

Kryetari i Bashkisë Z.Demo hapi fjalën e tij duke filluar me pasqyrimin se çfarë bashkia po përpiqet konkretisht të bëjë për rinine. Kur bëhet fjala për rininë tha Z.Demo janë projektet ato të cilat tregojnë se çfarë bashkia ka ndërmarrë të bëjë. Kryetari vuri theksin në fjalën e tij ku prezantoi më shumë detaje projektin e Shkollës së mesme “Babë Dude Karbunara”. Ndalem në këtë pikë tha kryetari sepse është pikërsiht shkolla ajo që lidhet direkt me të rinjte. Z. Demo në parantezë u bëri me dije të rinjve që të jenë më aktivë dhe të jenë zë për qytetin e tyre. Dua të mbaj në vëmendje Shkollën “Babë Dude Karbunara” duke qënë se cilësohet si universiteti Beratit dhe për më tëper duke qënë ish-nxënës i saj. Ashtu si kjo qëndër rinore të jep ndjesinë e qenit mirë ashtu edhe shkolla duhet të jap atë ndjesi për nxënësit: - tha Z. Demo. Projekti i parë që unë ndërmorra të bëj kur unë morra mandatin si kryetar bashkie përmendi Z.Ervin ishte shkolla “Bab Dude Karbunara” Me anë të këtij projekti kemi konceptuar një shkollë që të plotësojë të gjitha kushtet dhe standartet bashkëkohore, duke filluar që nga akomodimi i mirëfilltë i klasave, laboratorëve etj. Po ashtu kryetari bëri të qartë se kjo shkollë do ketë një auditor të madh me gati 100-200 vende në mënyrë që të rrinjtë të zhvillojnë aktivitetet shkollore, pjesë e shkollës do të jetë dhe një palestër me rreth 600 m2, do të ketë 36 klasa nga 24 që ka patur, ku klasa më e vogël do të jetë 35 m2, do të ketë zyra të posacme për psikologun, stafin drejtues e po ashtu do të jetë e vetmja shkollë tha kryetari që do të ketë fushë-basketbolli me kushte dhe standarte bashkëkohore. Aty ku vuri dhe më tepër theksin z. Demo ishte se ambientet e kësaj shkolle do të mund të përdoren si nga nxënësit e kësaj shkolle ashtu dhe të shkollave të tjera, si brenda orarit mësimor ashtu dhe jashtë tij. Gjatë fjalës së tij kryetari shumë optimist tha se aryesja pse i kemi rritur kapacitetet e shkollës është sepse jam i bindur që numri i nxënësve do të jetë në rritje dhe jo në ulje. Me besim të plotë përmendi ai se kjo sforco buxhetore dhe ndihma e qeverisë do të bëjmë që Shkolla e Mesme “Bab Dude Karbunara” do të jetë një nga shkollat më të bukura në Shqipëri. Ai premtoi se shtatorin ne ardhshëm shkolla do të hapet dhe do të mund të mirëprese të gjithë nxënësit në një ambient me kushte dhe standarte bashkëkohore. Ato çfarë na kanë ndalur për të mos e realizuar këtë project më shpejt tha kryetari ka qënë termeti i datës 26 Nëntor 2019 si dhe pandemia në vitin 2020. Përvec këtij projekti të rëndësishëm, ne do të ndërtojmë kënde sportive dhe kende lojrash për fëmijët e qytetit por jo

vetem. Besoj shume që ne do të bëjmë atë çfarë është e domosdoshme për qytetin, të ofrojmë mundësi ku ju të ndërtoni të ardhmen këtu. Në sektorin e turizmit, Beratit nga një qytet të magjishëm do ta kthejmë në qytet të jashtëzakonshëm por kjo bëhet duke qënë të gjithë bashkë, ku protagonistët kryesorë të jeni ju, të rinjtë – mbylli fjalën e tij Kryetari.

Pas fjalimit të kryetarit, fjalën e morri **Drejtori Ekzekutiv i INFOCIP (Qendra për Cështjet e Informimit Publik) , z.Gerti Shella**. Në këtë pikë të diskutimit z.Shella i shprehu përgëzime Kryetarit për gjithë punën e bërë në Bashkinë Berat dhe u shpreh se Berati ka vetëm jo potencialin apo fuqinë për t’u zhvilluar, por po ashtu zërin e të rinjve, për ta kthyer Beratit realisht në atë që meriton të jetë. Gjatë fjalës së tij ai bëri me dije se Bashkia Berat është një ndër shtatë bashkitë fituese për të konsoliduar një model të avancuar konsultimi publik duke u replikuar në një kohë të dytë në të gjithë bashkitë e vendit, ku të gjitha grupet e interesit të bëhen bashkë dhe të diskutojnë. Tani që flasim jemi në vigjilje të diskutimit të Projekt- Buxhetit dhe është në mirë të Beratit që edhe Këshilli Vendor Rinor të paraqesë kërkesat , idetë duke u mbështetur edhe në të drejtat që parashikon Ligji nr.75/2019 “Për Rininë” . Z.Shella ju drejtua me shumë optimizëm të rinjve ku u bëri me dije që ata të adresojnë një vision të tyre, sugjerimet apo edhe problematikat që hasin. Bashkia e Beratit është ndër bashkitë me të sukseshme, që po realizon edhe konsultimin e parë publik me të rinjtë, për pasojë Këshilli Vendor Rinor të artikulojë vetveten dhe të jetë në krah të Bashkisë. Gjatë fjalës së tij, u pyet nga Drejtuesja e Qendrës Rinore se çfarë konkretisht përfaqëson Projekti STAR. Në përgjigjen tij Z.Shella ishte i qartë dhe konciz duke bërë me dije se Projekti Star ndihmon bashkitë që të funksionojnë më së miri duke ju përshtatur kushteve të reja. Në mbyllje të fjalës së tij, ai u bëri dhe njëherë me dije të rinjve se do të kenë mbështetje dhe të shprehnin lehtësisht çdo sugjerim, kërkesë, ide problematikë etj.

Pas mbylljes së fjalës të Z. Shella, fjalën e morri **anëtarja e Këshillit Vendor Rinor Mishel Sinomi**, nxënëse në Shkollën e Mesme, Viti i Dytë. Zj.Mishel prezantoi Këshillin Vendor Rinor sesi funksionon konkretisht ky këshill me të rinjtë dhe bëri me dije se nëpërmjet këtij këshilli janë zhvilluar trajnime të ndryshme, ku njëri prej të cilëve është zhvilluar në muajin Gusht me temë sesi të parandalojmë emigrimin masiv të të rinjve. Këshilli Vendor Rinor, ka për qëllim bërjen e një jetë më të mirë dhe më aktive për të rinjtë e Beratit prandaj ne bëjmë thirrje për t’u bërë të gjithë bashkë dhe të ecim përpara:- Zj.Mishel.

Pas fjalës së anëtarës së Këshillit Vendor Rinor diskutimi u la i hapur për të shprehur mendimin të gjithë të rinjtë pjesëmarrës. **Nxënësja e parë që morri fjalën ishte Sidorela Mucogllava nga shkolla e Mesme “Bab Dude Karbunara”.** Zj.Sidorela i shprehu falenderime dhe mirënjohje kryetarit për projektin tashmë në realizim për shkollën dhe gjithëcka ka bërë për qytetin. Kërkesa ime tha ajo lidhet me hapjen e një klubi robotike dhe informatike duke qënë se janë dy nga degët më të kërkuara dhe me shumë interes për ne të rinjtë në ditët e sotme.

Pas fjalës së zj.Sidoreles, nxënësi tjetër që morri fjalën dhe shprehu sugjerimin e tij ishte **Marleo Jullumai.** Gjatë fjalës së tij pati një sugjerim që lidhej me ndërtimin e një skuadre basketbolli të emërtuar “Tomori” duke qënë se jemi një grup të rinjsh mjaft të talentuar për ta përfaqësuar shkollën më së miri, por për këtë do të na duhen fusha dhe kënde sportive.

Pas fjalës së nxënësit Marleo fjalën e morri **nxënësja Brisilda Nazifi,** e cila mbështeti mendimin e parafolësit dhe solli në vëmendje si sugjerim që të mos fokusi të mos jetë vetëm shkolla “Bab Dude Karbunara” por edhe shkolla të tjera. Po ashtu nje problem tjetër që ajo paraqiti ishte mungesa e aboneve për nxënësit duke pretenduar se në të gjitha qytetet e tjera kjo gjë është e mundur ndërsa në qytetin e Beratit jo.

Pas gjithë diskutimit mes të rinjve dhe dhënies së ideve të tyre tre ishin rekomandimet kryesore që ju paraqitën si kërkesa nga të rinjtë për Kryetarit të Bashkisë:

1. Ndërtimi i Klubit të Robotikës dhe Informatikës me qëllim që nxënësit e prirur drejt kësaj fushe të keni mundësi zhvillimin e njohurive të tyre.
2. Krijimi i një skuadre basketbolli me emrin “Tomori” duke qënë se ka shumë të rinj të talentuar në këtë fushë dhe kanë dëshirë për ta përfaqësuar shkollën e tyre më së miri.
3. Të bëhet e mundur ekzistenca e aboneve për nxënësit duke pretenduar që në qytetet e tjera ekziston.

Kryetari i Bashkisë duke dëgjuar me vëmendje deri në fund kërkesat, sugjerimet idetë e të rinjve, e duke u fokusuar në mënyrë të posacme në ato që janë parshtruar më sipër , bëri me dije se:

1. Përsa i përket ndërtimit të klubit të robotikës dhe informatikës, bazuar në interesin e lartë tuajin për të ndjekur edhe studimet e larta në atë fushë, por edhe duke patur parasysh që janë fusha që të cojnë drejt së ardhmës, vitin që vjen këtë kërkesë do ta realizojme ; - tha

kryetari, duke siguruar edhe bazën material, internetin, kompjuterat, një specialist për t'ju ndihmuar etj

2. Përsa i përket krijimit të skuadrës së basketbollit edhe këtë kërkesë e mirëpriti duke qënë se shkolla do të ketë edhe një ambient sportive mjaft bashkëkohor. Nëse të rinjtë janë të gatshëm për t'u bërë një skuadër dhe për të përfaqësuar shkollën e tyre, do të kenë mbështetje pavarësisht edhe problemeve që hasen
3. Për kërkesën e treta ne nuk harrojmë shkollat e tjera tha kryetari, Shkolla juaj në fakt është profesionale dhe nuk varet shumë nga ne por gjithësesi ju duhet të aktivzoheni më tepër për të aritur në nivele të duhura. Po ashtu nëse ju keni nevojë për ambiente për të zhvilluar aktivitete apo cfaredo lloj gjeje brenda kuadrit të programit mësimor shkolla "Bab Duda" është e hapur për të gjithë. Ndërsa për abonene, duke qënë se shkolla nuk ka ndonjë largësi shumë të madhe nuk mendoj se është shumë e nevojshme, ndërsa për nxënësit që e kanë distancën e largët e kanë të siguruar transportin duke i garantuar të drejtën e arsimit, si të drejtë themelore dhe kushtetuese. Përsai i përket shkollave profesionale, e vetmja mbështetje është që ne ofrojmë konvikte shumë të mira për nxënësit që vijnë nga larg; - u shpreh kryetari. Gjithsesi edhe për abonene do ta mendoj dhe do të keni një përgjigje.

Pas diskutimit shumë të frytshëm, fjala në mbyllje ju kalua edhe njëherë Drejtorit Ekzekutiv të INFICIP, z.Gerti Shella. Z.Shella i solli në vëmendje të rinjve që posacërisht për ta është miratuar ligji nr.79/2015 "Për Rininë" ku njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për: pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre, krijimin e këshillit vendor të rinisë, organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve, organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve; nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre; financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta; krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë; parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore; mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre. Këto të drejta ua garanton ligji dhe ju

duhet t'i kërkonti por edhe të punoni për të bërë realitet kërkesat tuaj ; - u shpreh Z.Shella. N e do të vazhdojmë bashkëpunimin tonë edhe do të përpiqeni për të realizuar projekte të mirëfillta për rininë, nga ne do të keni mbështetje – mbylli fjalën e tij Z.Gerti Shella.

Takimi zgjati rreth 1:30 minuta dhe u mbyll në orën 12:30

FOTO – GALERIA E KONSULTIMIT.





LISTE - PREZENCA






NR	EMER/MBIEMER	PROFESIONI	Bashkia/ NJ.A	KONTAK/ FIRMA
1.	Erinda Sakollaj	Studente	Berat	0683604737 <i>[Signature]</i>
2.	Marjola Joska	Studente	Berat	0683041782 <i>[Signature]</i>
3.	Fabjana Luzi	Studente	Berat	0696309718 <i>[Signature]</i>
4.	Eniana Sakollaj	studente	Berat	0695777346 <i>[Signature]</i>
5.	Adenajda Pupa	Studente	Berat	0676903027 <i>[Signature]</i>
6.	Valeria Koxhaj	Studente	Berat	0694748207 <i>[Signature]</i>
7.	Bejana Xheringja	Studente	Berat	0688215445
8.	Livia Blana	Studente	Berat	0682234053

9.	Brusjana Zoga	Studente	Berat	0683773416
10.	Rezarta Balla	Studente	Berat	0683902550
11.	Dea Bokaj	Studente	Berat	0677102812
12.	Emilio Ziraj	Student	Berat	0683140019
13.	Kostandin Kola	Student	BERAT	0682283461
14.	Redjon Ajdinaj	Student	Berat	0683744794
15.	Alena Zanellari	Studente	Berat	0683832656
16.	Laura Toto	Mësuese	Berat	0692112031
17.	Skenderilda Lemdari	Studente	Berat	
18.	Sanela Xheja	Studente	Berat	0682711195
19.	Hijrete Kanesi	studente	Berat	

20.	Ediola Çela	studente	Berat	0683522891
21.	Brisilda Nazifi	Studente	Berat	0694687846
22.	Matilda Ardyl	studente	Berat	0695259893
23.				
24.	Dajana Hyskaj Elidjan Taraka	Studente STUDENT	Berat Berat	0694447105 0699681226
25.	LENO KAJA	STUDENT	Berat	0575914897
26.	Iva Koka	Studente	Berat	0695333218
27.	Natalja Mamurani	Studente	Berat	0694736337
28.	Blikeni Çoka	Studente	Berat	0688295065
29.	Marko Xheblati	Student	Berat	0695593495
30.	Ensara Shosha	Studente	Berat	0693160250

31.	Anila Namani	studente	Berat	0682454616
32.	Elvira Hyseni	studente	Berat	0683965296
33.	Legjona Bregu	studente	Berat	0693718226
34.	Herka Mejdani	studente	Berat	
35.	Fabjana Sharavalli	studente	Berat	
36.	Noemi Mejdani	studente	Berat	
37.	Klaudija Zyberi	studente	Berat	
38.				
39.	Kejsiana Çeço Sidoela Masogllava	studente studente	Berat Berat	0693800761
40.	Klodian Hoxha	Drejtor DA	Berat	
	Pajfela Protani	Studente	Berat	
	Miranda Velollari	Drejtor shkolle	Berat	
	Elton Dhima	Drejtor Fajelokesh	Berat	0682207728
	ERVIN DEMO	KRYETAR i BASHKISE	BERAT	

Hegi	Kanasi	studente	Berat
Anxhela	Safa	Studente	Berat
Laura	Angjelis	Studente	Berat
Ajma	Dollani	Studente	Berat
Xhesada	Korkanjozi	Studente	Berat
Emiliano	Kosemi	Student	Berat
Palikseni	Stefani	Studente	Berat
Egesa	Mali	Studente	Berat
Klejsanta	Selami	Studente	Berat
Jorkida	Merkaaj	Studente	Berat
Elisa	Qabo	Studente	Berat
Amarda	Lance	Studente	Berat
Ioana	Merkaaj	Studente	Berat
Fjona	Nako	Studente	Berat
Ena	Suborani	Studente	Berat

Alesio	Agalliu	studente	Berat	
Estrela	Sado	studente	Berat	
Marles	Tullumani	student	Berat	
Froso	Minollari	studente	Berat	
Theodhora	Tullumani	studente	Berat	

Pergatiti: Etleva Dhima – Drejtore e Integritit Europian dhe Projekteve

